

## Letër nga Qielli

### Fan S.Noli: Edhe unë kam folur “pasi më ka ikur karrigia”

[Gazeta Sot, 8.2.2006, teksti në vijim, nuk është fjalë për fjalë, ai i botuari: është redaktuar pas botimit, nga unë, dhe para botimit, nga “Sot”. Ky është teksti që përfaqëson qëndrimin tim.]

Kisha kohë që matesha t’ju shkruaja: pika “që derdhi gotën” qe shkrimi i botuar në faqen 11 të gazetës tuaj të nderuar, më 5.2.2005, me titull “Zyrtarët që flasin kur u ikën “karrikja”. Fjalën “karrikja” e kam shkruar siç e ka shkruar shkruesi i shkrimit, se unë, që nga viti 1972, kur u bë kongresi i drejtshkrimit në Shqipëri, nuk ma mban ta shkruaj ashtu, se do më thonë njeri që nuk zbaton rregullat e vendi tënd, e pikërisht § 32 të “Drejtshkrimit të Gjuhës Shqipe”, ku tregohet se duhet shkruar “karrigia”. Nejse, punë e tij, por edhe e jona.

Edhe unë kam folur e shkruar shumë pasi më “ka ikur karrigia e kryeministrit”, dhe kam shkruar në shumë fusha (përkthime, publicistikë, poezi, gjuhë, muzikë, diplomaci, teologji, politikë, etj)—por nuk duhet të më bëjë njeri fajtor për këtë, siç më bën shkruesi i atij shkrimit, por e kundërta, prisja të më përgëzonin. Unë kam qenë kryeministër, në vitin 1924—e them këtë, sepse konstatoj se shkruesi i atij shkrimit, i ngatërron disa gjëra. Për shembull, ngatërron ministrin me zëvendëskryeministrin, kur bën aludime edhe për një koleg timin më të ri, që është aty poshtë me ju, që edhe atij “i ka ikur karrigia”, e që edhe ai flet e shkruan. Këtë ngatërresën ministër/zëvendëskryeministër, shënojeni si lapsusin e dytë, që detyrohem t’i korrigjoj, në mënyrë eksplicite (haptas, jo ndërmjet rreshtave) dhe publikisht, autorit të atij shkrimit, korrigjimet e tjera nuk po ia numroj.

Në të gjithë botën demokratike, qënia “ish” nuk është turp, sepse në demokraci është normale që menjëherë të bëhesh ish—nuk duron demokracia e vërtetë, prijës të përjetshëm si tek ju, e “që i mbarojnë të gjitha”, pa u lënë gjë për të menduar e për të kryer, të tjerëve! Vetëm në komunizëm e në diktaturat e tjera, nuk mund të jeshë ish, pra edhe nuk mund të shkruash si ish, sepse po u bëre ish, të zhdukim nga faqia e dheut.

Kritizerëve, u kujtoj se është pa fund “e lëna pa bërë”, nga kushdo që ka qenë, në çfardo posti.

Nuk është faj të shkruash në shumë fusha, dhe më duket e padrejtë, që t’i kufizohet tjetrit statura, duke i përmendur profesionin e tij të rinisë, p.sh. mua “prift”, e kolegut tim “inxhinjer”, me gjithë se kemi kaluar një jetë në shumë angaxhime të tjera. Është njësoj si t’i thuash, Çehovit (shkrimtarit), mjek, apo t’i thuash një plaku “piciruk”, duke u nisur nga statusi i tij i para 70 vjetëve. Nuk e di se përse i jepni kaq rëndësi “diplomave” (çertifikimeve) ju të sotmit, aq më tepër ju që, siç jemi njoftuar, e keni diplomën mall fare të lirë: në komunizëm, shumë nga ju, e blinit çertifikimin me biografira, kurse në demokracinë tuaj, shumë nga ju e blini me para, pa studiuar e humultuar fare, siç na duhet të bëjmë ne që shkruajmë “në fusha të ndryshme”. Pra mos kërkoni “diploma” (“çertifikime si specialistë të fushës”) nga ata që shkruajnë, por kërkoni të ketë mend e ndershmëri, në ato që shkruajnë. Është një lloj censure, edhe ajo që bëhet nëpërmjet “kërkesës për të qenë i çertifikuar, pa të lejohesh të shkruash”—e nga kush të jeshë i çertifikuar pa, nga ata që shesin diploma?!

Liria e fjalës, është një ndër arritjet e civilizimit botëror, dhe që nuk duhet dhunuar, as me dajak fizik, dhe as me dajak psiqik. Dajakun e parë, atë fizik, e kanë dhënë shumë vetë, e vetëm këto vitet pasi lashë postin e kryeministrit, mund të përmend Hitlerin, Stalini, Enverin e deri te z. Berisha kur ishte president, në vitin 1992-97. Dajakun e dytë, atë psiqikun, e japin shumë vetë, për motive që nuk po i përmend.

Edhe liria e mos leximit të asaj që nuk të pëlqen, është një arritje e civilizimit, pra ka të drejtë kushdo të kthejë faqen kur nuk i pëlqen shkrimi, apo të ndërrojë stacion kur nuk don të dëgjojë—shyqyr që ju të rrinjtë, e rrëzuar komunizmin, dhe me të edhe “format politike me detyrim”, që ai i kishte aq shumë qejf, e ku detyroheshit të lexonit e të dëgjonit gjëra që nuk ju pëlqenin fare, pavarësisht se i thonin “gjuhëtarë” apo “lektorë” të çertifikuar të komunizmit.

Shumë kolegëve këtu në Qiell, presidentë, kryeministra, deputetë, e deri drejtorë drejtorie, e edhe pastrues të thjeshtë të dikastereve, qeshën me njohuritë e kufizuara të shkruarit të atij shkrimi, që nuk e dinte se edhe ata, sa ishin gjallë e kur kishin forca, guxim dhe aftësi, kanë pasë shkruar mbasi “u kishte ikur karrigia”, me që e quanin për detyrë të shprehin mendimet e tyre, ani se nuk u pëlqente mbase, qeveritarëve që pasonin—kjo dallon njeriun e lirë nga “skllavi i lindur”: sensi i detyrës ndaj të tjerëve, edhe kur materialisht, veçse humbje kanë.

Kam kuriozitet se si do të reagojnë ndaj atij shkrimit, Klintoni, ish-presidenti i Amerikës, që edhe ai shkruan e flet, edhe pa e pyetur njeri fare, bile pa i marrë leje as shkruarit të atij shkrimit, e kështu edhe shumë të tjerë, qoftë ministra a deputetë, a ish-ë të tjerë, që shkruajnë dhe flasin, me gjithëse “u ka ikur karrigia”.

Ju bekoftë Perëndia.

I juaji

Fan S. Noli

Ish-kryeministër i Shqipërisë

Ky shkrim është një replikë ndaj shkrimit “Zyrtarët që flasin kur u ikën “karrikja”, më 5.2.2005, nga Ylber Memia.

Bashkim Kopliku

Durrës, më 8.2.2006